



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VII
Sesioni pranveror

Kryesia e Kuvendit

P-016
Prishtinë, më 8 qershor 2020, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

IMBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 8 QERSHOR 2020

Në mbledhje morën pjesë: Vjosa Osmani-Sadriu, kryetare e Kuvendit; Arbërie Nagavci, Kujtim Shala, Memli Krasniqi dhe Slavko Simiq, nënkryetarë të Kuvendit.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga grupet parlamentare: Rexhep Selimi, Arben Gashi, Elmi Reçica, Teuta Haxhiu dhe Haxhi Shala.

Nga Kabineti i kryetares: Faton Peci dhe Artan Murati.

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Xheladin Hoxha, Sali Rexhepi, Musli Krasniqi dhe Shefki Shoshaj.

Nga KDI-ja: Agnesa Haxhiu.

Mbledhjen e drejtoi kryetarja e Kuvendit, znj. Vjosa Osmani-Sadriu.

Kryesia, me propozimin e kryetares, i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mëparshme e Kryesisë së Kuvendit,
2. Kërkesa e kryeministrit për seancë të jashtëzakonshme të Kuvendit
3. Shqyrtimi i propozimeve dhe i kërkesave,
4. Materialet e proceduara nga Qeveria ne Kuvend, pas miratimit të Mocionit të mosbesimit ndaj Qeverisë së Kosovës, më 25 mars 2020,
5. Të ndryshme.

* * *

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mëparshme e Kryesisë së Kuvendit

Kryesia i miratoi pa vërejtje procesverbalet e mbledhjeve të mbajtura më 28 maj dhe 2 qershor 2020.

2. Kërkesa e kryeministrit të Republikës së Kosovës për seancë të jashtëzakonshme

Kryetarja i njoftoi të pranishmit me kërkesën e kryeministrit të Republikës së Kosovës, Avdullah Hoti, për mbajtje të seancës së jashtëzakonshme të Kuvendit.

Kryetarja sqaroi se kryeministri i Republikës së Kosovës, Avdullah Hoti, në mbështetje të nenin 69, paragrafi 4 i Kushtetutës, ka parashtruar kërkesë për mbajtje të seancës së jashtëzakonshme të Kuvendit, për ditën e martë, më 9 qershor 2020, në orën 12:00, për shqyrtimin e vendimeve të Qeverisë së Republikës së Kosovës: Vendimi nr. 03/02, të datës 5 qershor 2020, me të cilin kërkohet nga Kuvendi i Republikës së Kosovës të bëjë ndryshimin dhe tejkalimin e përkohshëm të rregullave fiskale të deficitit, si dhe kufizimit të bilancit bankar të përdorshëm.

Pastaj, kryetarja theksoi se Qeveria e Kosovës me Vendimin nr. 02/03, të datës 6 qershor 2020, ka konfirmuar për procedim të mëtejshëm për shqyrtim në Kuvendin edhe disa vendime të Qeverisë së Kosovës së mëparshme, pa pasur nevojë të riprocedohen prej fillimi, dhe atë:

1. Projektligji për ratifikimin e Marrëveshjes për financim ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim për Projektin e Fuqizimit të Sektorit Financiar,
2. Projektligji për ratifikimin e Marrëveshjes për hua ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim për Projektin e Zhvillimit të Ujërave të Zeza në Gjilan,
3. Projektligji për ratifikimin e Marrëveshjes për financimin e projektit për Kadastër të Patundshmërisë dhe Infrastrukturë Gjeohapësinore ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim,
4. Projektligji për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Republikës së Kosovës mbi Pjesëmarrjen e Kosovës në Programin e Bashkimit “Dogana 2020”,
5. Projektligji për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Republikës së Kosovës mbi pjesëmarrjen e Kosovës në Programin “Fiskalis 2020”,
6. Raporti vjetor financiar të Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2019,
7. Korniza afatmesme e shpenzimeve 2021-2023, për njoftim,
8. Programi i Borxhit Shtetëror 2021-2023, për njoftim.

Më pas, kryetarja hapi diskutimet në lidhje me kërkesën lartshënuara.

Në lidhje me kërkesat e lartshënuara, diskutuan: nënkryetarja e Kuvendit, Arbërie Nagavci, dhe kryetari i GP të LDK-së, Arben Gashi, i cili theksoi se me pëlqimin e Qeverisë, seanca plenare e rregullt mund të mbahet të enjten, më 11 qershor 2020.

Kryesia me pëlqimin e përfaqësuesve të grupeve parlamentare vendosi që Kuvendi të mbajë seancë plenare të enjten, më 11 qershor 2020, në orën 10:00, me këtë:

Rend dite

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Miratimi i procesverbaleve nga seancat e mëparshme,
3. Shqyrtimi i Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, nr. 02/03 datë 5. 6. 2020, për ndryshimin dhe tejkalimin e përkohshëm të rregullave fiskale të deficitit, si dhe kufizimit të bilancit bankar të përdorshëm,
4. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes për financim ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim për Projektin e Fuqizimit të Sektorit Financiar,
5. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes për Hua ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim për Projektin e Zhvillimit të Ujërave të Zeza në Gjilan,
6. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes për Financimin e Projektit për Kadastër të Patundshmërisë dhe Infrastrukturë Gjeohapësinore ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim,

7. *Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Republikës së Kosovës mbi pjesëmarrjen e Kosovës në Programin e Bashkimit “Dogana 2020”,*

8. *Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Republikës së Kosovës mbi pjesëmarrjen e Kosovës në Programin e Bashkimit “Fiskalis 2020”,*

9. *Shqyrtimi i raportit vjetor financiar të Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2019.*

Kryesia, gjithashtu, në lidhje me pikat 3 deri 9 të lartshënuara, nxori edhe këto përfundime:

I.

P Ë R F U N D I M

1. Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 02/03, datë 5. 6. 2020, me të cilin kërkohet nga Kuvendi i Republikës së Kosovës të bëjë ndryshimin dhe tejkalimin e përkohshëm të rregullave fiskale të deficitit, si dhe kufizimit të bilancit bankar të përdorshëm.

2. Ngarkohet Komisioni për Buxhet dhe Transfere, si komision funksional, që ta shqyrtojë Vendimin e Qeverisë dhe Kuvendit t’ia paraqesë raportin me rekomandime, para se të mbahet seanca plenare, e caktuar për datën 11 qershor 2020.

II.

P Ë R F U N D I M

1. Projektligji për ratifikimin e Marrëveshjes për financim ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim për Projektin e Fuqizimit të Sektorit Financiar t’u shpërndalet deputetëve.

2. Ngarkohet Komisioni për Buxhet dhe Transfere, si komision funksional, që ta shqyrtojë projektligjin dhe Kuvendit t’ia paraqesë raportin me rekomandime para se të mbahet seanca plenare, e caktuar për datën 11 qershor 2020.

III.

P Ë R F U N D I M

1. Projektligji për ratifikimin e Marrëveshjes për hua ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim për Projektin e Zhvillimit të Ujërave të Zeza në Gjilan t’u shpërndalet deputetëve.

2. Ngarkohet Komisioni për Buxhet dhe Transfere, si komision funksional, që ta shqyrtojë projektligjin dhe Kuvendit t’ia paraqesë raportin me rekomandime para se të mbahet seanca plenare, e caktuar për datën 11 qershor 2020.

IV.
P Ë R F U N D I M

1. Projektligji për ratifikimin e Marrëveshjes për financimin e Projektit për Kadastër të Patundshmërisë dhe Infrastrukturë Gjeohapësinore ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim t'u shpërndahet deputetëve.
2. Ngarkohet Komisioni për Buxhet dhe Transfere, si komision funksional, që ta shqyrtojë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesë raportin me rekomandime para se të mbahet seanca plenare, e caktuar për datën 11 qershor 2020.

V.
P Ë R F U N D I M

1. Projektligji për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Republikës së Kosovës mbi Pjesëmarrjen e Kosovës në Programin e Bashkimit "Dogana 2020" t'u shpërndahet deputetëve.
2. Ngarkohet Komisioni për Buxhet dhe Transfere, si komision funksional, që ta shqyrtojë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesë raportin me rekomandime para se të mbahet seanca plenare, e caktuar për datën 11 qershor 2020.

VI.
P Ë R F U N D I M

1. Projektligji për Ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Republikës së Kosovës mbi Pjesëmarrjen e Kosovës në Programin e Bashkimit "Fiskalis 2020", t'iu shpërndahet deputetëve.
2. Ngarkohet Komisioni për Buxhet dhe Transfere, si komision funksional, që ta shqyrtojë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesë raportin me rekomandime para se të mbahet seanca plenare, e caktuar për datën 11 qershor 2020.

* * *

Gjithashtu, Kryesia në lidhje me Vendimin e Qeverisë që ka të bëjë me materialet e proceduara në Kuvend nga Qeveria në dorëheqje, për të cilat Qeveria e tanishme ka dhënë pëlqimin për procedimin e tyre në Kuvendin e Kosovës, nxori edhe këto përfundime:

I.
P Ë R F U N D I M

Programi i Borxhit Shtetëror 2021-2023 t'u shpërndahet deputetëve për njoftim.

II. P Ë R F U N D I M

Korniza afatmesme e shpenzimeve 2021-2023 t'u shpërndahet deputetëve për njoftim.

* * *

3. Shqyrtimi i propozimeve dhe i kërkesave

Kryetarja i njoftoi të pranishmit se për procedimin e katër (4) nismave legislative të parashtruara nga Kuvendit, përkatësisht deputetët dhe grupet parlamentare, për procedimin e të cilat është diskutuar në mbledhjet e mëparshme të Kryesisë, por nuk ka pasur konsensus për procedimin e tyre për mendim në Qeverinë në dorëheqje, si në vijim:

3.1 Projektligji për parandalimin dhe luftimin e pandemisë COVID-19 në territorin e Republikës së Kosovës

Projektligjin e lartshënuar e ka hartuar dhe propozuar kryetarja e Kuvendit, e mbështetur edhe nga 5 deputetë tjerë nënshkrues.

3.2 Projektligji për masat e përkohshme për ta lehtësuar efektin e pandemisë COVID-19, i hartuar dhe propozuar nga Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës.

3.3 Projektligji për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 03/L-048 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, i plotësuar dhe i ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-221, me Ligjin nr. 04/L-116, me Ligjin 04/L-194, me Ligjin 05/L-063, dhe me Ligjin 05/L-00, i hartuar dhe propozuar nga Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës.

3.4. Projektligji për mbrojtjen e vlerave të luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, i hartuar deputeti Gazmend Bytyçi nga Grupi Parlamentar i PDK-së, i mbështetur edhe nga 19 deputetë tjerë nënshkrues.

Në lidhje me procedimin e katër (4) nismave legislative të lartshënuara diskutuan: Kryetarja e Kuvendit, Vjosa Osmani-Sadriu: Arbërie Nagavci, Kujtim Shala dhe Memli Krasniqi, nënkryetarë të Kuvendit, si dhe Elmi Reçica, në emër të GP të PDK-së, Rexhep Selimi, në emër të GP të LVV-së dhe Teuta Haxhiu, në emër të GP të AAK-së, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Pas diskutimeve, Kryesia vendosi që katër (4) nismat legislative të lartshënuara t'ia dërgojë për mendim Qeverisë së Republikës së Kosovës, e cila duhet ta përgatisë Deklaratën e ndikimit buxhetor dhe Deklaratën për përafrim me legjislacionin e BE-së për të gjitha projektligjet në afatin prej një (1) muaji nga dita e pranimit.

3.5 Propozim - Rregullorja për shfrytëzimin e automjeteve të Kuvendit të Kosovës

Kryetarja i njoftoi të pranishmit se për Propozim-Rregulloren për shfrytëzimin e automjeteve të Kuvendit të Kosovës është diskutuar edhe në mbledhjen e Kryesisë së Kuvendit, e mbajtur më 28 maj 2020. Për sqarime më të hollësishme, fjalën ia tha sekretarit të Kuvendit.

Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit, Ismet Krasniqi, ia paraqiti Kryesisë së Kuvendit informatën e përgatitur në lidhje me mundësitë buxhetore për zbatimin e Propozim-Rregullore së lartshënuar dhe për gjendjen e automjeteve të Kuvendit.

Diskutimi i plotë e Sekretarit është i dhënë në transkript.

Në lidhje me Propozim-Rregulloren për shfrytëzimin e automjeteve të Kuvendit të Kosovës diskutuan: kryetarja e Kuvendit, Vjosa Osmani-Sadriu, dhe nënkryetarët e Kuvendit: Arbërie Nagavci dhe Memli Krasniqi, si dhe Elmi Reçica, në emër të GP të PDK-së, Rexhep Selimi, në emër të GP të LVV-së dhe Arben Gashi, në emër të GP të LDK-së, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Pas diskutimeve, Kryesia e miratoi Rregulloren për shfrytëzimin e automjeteve të Kuvendit të Kosovës.

Kryesia, po ashtu, në lidhje me çështjen e mjeteve buxhetore për zbatimin e Rregullore së lartshënuar, sa i përket marrjes në shfrytëzim të shtatë veturave shtesë të reja me qira, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Autorizohet Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit, z. Ismet Krasniqi, që të paraqesë kërkesë në Komisionin për Buxhet dhe Transfere për planifikimin e mjeteve buxhetore gjatë rishikimit të Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2020 për marrjen në shfrytëzim të shtatë veturave shtesë të reja me qira.

3.6. Propozim-Rregullorja për rendin dhe qasjen e mediave dhe të publikut në punën e Kuvendit

Kryetarja i njoftoi të pranishmit se Rregullorja për rendin dhe qasjen e mediave dhe të publikut në punën e Kuvendit është miratuar në mbledhjen e Kryesisë së Kuvendit, e mbajtur më 28 maj 2020. Mirëpo, për këtë mbledhje ka mbetur të sqarohe, rregulla 10, pika 2, rregulla 18 dhe rregulla 21 e kësaj Rregulloreje.

Pastaj, ajo e ftoi Sekretarin e Përgjithshëm të Kuvendit, Ismet Krasniqi, për sqarime në lidhje me rregullat e lartshënuara të Rregullore në fjalë.

Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit, Ismet Krasniqi, ia dha sqarimet e nevojshme Kryesisë së Kuvendit në lidhje me rregullat e lartshënuara të Rregullores në fjalë. Diskutimi i plotë e Sekretarit është dhënë në transkript.

Në lidhje me Propozim-Rregulloren në tërësi me sqarimet e rregullave të lartshënuara diskutuan: kryetarja e Kuvendit, Vjosa Osman-Sadriu, si dhe Rexhep Selimi, në emër të GP të LVV-së, dhe Arben Gashi, në emër të GP të LDK-së, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Kryesia, pasi e shqyrtoi Propozim-Rregulloren për rendin dhe qasjen e mediave dhe të publikut në punën e Kuvendit, mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohet Rregullorja për rendin dhe qasjen e mediave dhe të publikut në punën e Kuvendit të Republikës së Kosovës.
2. Rregullorja nga pika një (1) e këtij Vendimi hyn në fuqi tetë (8) ditë pasi të publikohet në ueb-faqen e Kuvendit të Republikës së Kosovës.

3.7. Propozimi për ndryshimin e Rregullores nr. 05/Rr-002 për shpenzimin e buxhetit të Kuvendit nga Kategoria subvencione dhe transfere, me ndryshimet dhe plotësimet e datës 19 dhjetor 2016

Kryesia, pasi e shqyrtoi propozimin për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për shpenzimin e buxhetit të Kuvendit nga Kategoria subvencione dhe transfere, e ndryshuar dhe plotësuar më 19 dhjetor 2016, mori këtë:

V E N D I M

Miratohet Rregullorja për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores nr. 05/Rr-002 për shpenzimin e buxhetit të Kuvendit nga Kategoria subvencione dhe transfere, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 05/Rr.003, datë 19 dhjetor 2016.

3.8 Propozim-vendimi për formimin e Grupit punues për hartimin e Planit Strategjik të Kuvendit për periudhën 2021-2025

Kryesia, pasi diskutoi për hartimin e Planit Strategjik të Kuvendit për periudhën 2021-2025, mori këtë:

V E N D I M

- I. Formohet Grupi i Punës për hartimin e Planit Strategjik për Kuvendin e Republikës së Kosovës për periudhën 2021-2025, në këtë përbërje:

1. Ismet Krasniqi - Administrata e Kuvendit, kryesues,
2. Faton Peci, përfaqësues nga Kabineti i kryetares së Kuvendit, anëtar,
3. Përfaqësues nga Grupi Parlamentar i LVV-së, anëtar,
4. Përfaqësues nga Grupi Parlamentar i LDK-së, anëtar,
5. Përfaqësues nga Grupi Parlamentar i PDK-së, anëtar,
6. Përfaqësues nga Grupi Parlamentar i AAK-së, anëtar,
7. Përfaqësues nga Grupi Parlamentar i LS-së, anëtar,
8. Përfaqësues nga Grupi Parlamentar Nisma, anëtar,
9. Përfaqësues nga Grupi i Grave Deputete, anëtar,
10. Përfaqësues nga organizatat partnere të Kuvendit (OSBE, NDI, GIZ, UNDP, UNKT, Ambasada e Norvegjisë, Ambasada e Holandës),
11. Xheladin Hoxha, Administrata e Kuvendit, anëtar,
12. Emrush Haxhiu, Administrata e Kuvendit, anëtar,
13. Përfaqësues nga shoqëria civile, anëtar,
14. Shqipe Krasniqi, Administrata e Kuvendit, koordinatorë e procesit.

II. Për hartimin e Planit Strategjik të Kuvendit të Republikës së Kosovës, për periudhën 2021-2025, Grupi i punës do ta ketë mbështetjen profesionale dhe ekspertizën e nevojshme nga Stephen Batstone, ekspert/GIZ.

3.9 Formimi i grupeve të miqësisë

Kryesia, pasi diskutoi sërish në lidhje me formimin e grupeve të miqësisë ndërmjet Kuvendit të Republikës së Kosovës me parlamentet e shteteve tjera përsëri, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

1. Kërkohet nga grupet parlamentare: PDK, Lista serbe dhe deputetët e komuniteteve tjera që nuk janë shumicë, që mbi bazën e propozimit nga Kryesia e Kuvendit dhe sipas marrëveshjes për ndarjen e kryesimit të tyre për formimin e grupeve të miqësisë të Kuvendit të Republikës së Kosovës me parlamentet e shteteve tjera t'i propozojnë deputetët për kryetar, nënkryetar dhe anëtarë të grupeve të miqësisë deri para mbledhjes së radhës të Kryesisë së Kuvendit, sipas propozimit të bashkangjitur.

2. Kërkohet nga Grupi Parlamentar i LDK-së që t'i propozojë deputetët për zëvendësimin e ish-deputetëve: Arban Abrashi, Armend Zemaj, Driton Selmanaj, si dhe ta propozojë edhe një deputet për nënkryetar të grupit të miqësisë, sipas propozimit të bashkangjitur.

3. Kërkohet nga Grupi Parlamentar i AAK-së që t'i propozojë deputetët për nënkryetar të grupeve të miqësisë, sipas propozimit të bashkangjitur.

4. Kërkohet nga Grupi Parlamentar i Nismës Socialdemokrate që t'i propozojë deputetët për nënkryetarë të grupeve të miqësisë, sipas propozimit të bashkangjitur, si dhe ta propozojë një deputet për zëvendësimin e ish-deputetes, Albulena Balaj-Halimaj.

3. 10 Formimi i delegacioneve të Kuvendit për përfaqësim në organizata ndërkombëtare

Kryesia, pasi diskutoi për formimin e delegacioneve të Kuvendit për përfaqësim në organizata ndërkombëtare përsëri, nxori këto përfundime:

I.

P Ë R F U N D I M

Kërkohet nga deputetët e komuniteteve që nuk janë shumicë që ta propozojnë një deputet për anëtar të Delegacionit të Kuvendit të Kosovës në Asamblenë Parlamentare të Frankofonisë.

II.

P Ë R F U N D I M

I. Kryesia e Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 28 shkurt 2020, ka vendosur për formimin e Delegacionit të Kuvendit të Republikës së Kosovës në Komisionin Parlamentar për Stabilizim-Asociim BE-Kosovë, në përbërje prej 13 anëtarëve, si në vijim: 7 (shtatë) anëtarë nga pozita, duke përfshirë kryetarin e delegacionit dhe 6 (gjashtë) anëtarë nga opozita, duke përfshirë nënkryetarin e delegacionit.

II. Kërkohet nga grupet parlamentare, të cikat nuk i kanë dërguar propozimet që, sipas marrëveshjes së arritur në Kryesinë e Kuvendit, t'i propozojnë deputetët në Delegacionin e Kuvendit të Republikës së Kosovës në Komisionin Parlamentar për Stabilizim Asociim BE-Kosovë, si në vijim:

1. Grupi Parlamentar i LDK-së ta propozojë kryetarin e Delegacionit dhe zëvendësuesin e tij, si dhe një (1) anëtar dhe zëvendësuesin e tij.
2. Grupi parlamentar i LVV-së ta propozojë edhe një (1) anëtar dhe zëvendësuesin e tij.
3. Grupi Parlamentar i PDK-së t'i propozojë zëvendësuesit për nënkryetarin e Delegacionit, z. Enver Hoxhaj dhe për anëtarët Blerta Deliu-Kodra dhe Ariana Musliu-Shoshi.
4. Grupi Parlamentar Lista serbe ta propozojë një (1) anëtar dhe zëvendësuesin e tij.
5. Grupi parlamentar i Nismës Socialdemokrate ta propozojë zëvendësuesin e anëtarit, në vend të ish-deputetes Albulena Balaj-Halimaj.
6. Deputetë e komuniteteve tjera që nuk janë shumicë ta propozojnë zëvendësuesin e anëtarit të Delegacionit, z. Albert Kinolli.

4. Materialet e proceduara nga Qeveria në Kuvend, pas miratimit të Mocionit të mosbesimit ndaj Qeverisë së Kosovës, më 25 mars 2020

Kryesia pasi diskutoi në lidhje me materialet e proceduara nga Qeveria në Kuvend pas miratimit të Mocionit të mosbesimit ndaj Qeverisë, më 25 mars 2020, për të cilat Qeveria e re në Vendimin e saj, nr. 02/03, datë 8 qershor 2020, nuk është deklaruar për procedimin e tyre në Kuvendin e Kosovës, konstatoi se Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit t'i dërgojë shkresë zyrtare Sekretarit të Zyrës së Kryeministrit me të cilën kërkohet të Qeveria e Kosovës të deklarohet në lidhje me procedimin e çështjeve në vijim:

1. Projektligjin për plotësimin dhe ndryshimin e Kodit Nr. 04/L-123 të procedurës penale, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-091,
2. Raportin tremujor financiar për vitin 2020,
3. Programin Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (PKZMSA) 2020-2024, dhe
4. Raportin e Statistikave zyrtare për vitin 2019.

5. Të ndryshme

5.1 Kthimi në normalitet, rikthimi i deputetëve në ulëset e tyre, duke e lejuar edhe qasjen mediave dhe musafëve në sallën plenare

Në lidhje me kthimin e deputetëve në ulëset e tyre, si dhe lejimin dhe qasjen e mediave dhe musafëve në sallën plenare, kryetarja i njoftoi të pranishmit se ende janë në fuqi masat sipas rekomandimeve të Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike, kështu që për momentin nuk është mundësia që t'i kthehemi normalitetit gjatë zhvillimit të punimeve të seancave të Kuvendit.

5.2 Funkcionalizimi i Bordit të Grupit joformal të Grave Deputete

Kryesia, pasi diskutoi në lidhje me funksionalizimin e Bordit të Grupit joformal të Grave Deputete, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Kërkohet nga grupet parlamentare dhe deputetet e komuniteteve joshumicë që t'i dërgojnë propozimet e deputeteve për Bordin e Grupit joformal të Grave Deputete.

5.3 Rifunksionalizimi i Grupit joformal të Deputetëve të Rinj

Kryesia, pasi diskutoi në lidhje me rifunksionalizimin e Grupit joformal të Deputetëve të Rinj, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Kërkohej nga grupet parlamentare dhe deputetët e komuniteteve joshumicë që t'i dërgojnë propozimet për anëtarë të Grupit joformal të Deputetëve të Rinj.

5.4 Kërkesa e deputetes Mimoza Kusari-Lila për rifunksionalizimin e Grupit joformal të Deputetëve të Gjellbër

Kryesia, pasi diskutoi në lidhje me kërkesën e lartshënuar, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Kërkohej nga grupet parlamentare dhe deputetët e komuniteteve tjera jo shumicë që t'i dërgojnë propozimet e deputetëve në Grupin joformal të Deputetëve të Gjellbër për rifunksionalizimin e këtij grupi joformal.

5.5 Njoftimi i Asamblesë Parlamentare të Procesit të Bashkëpunimit për Evropën Juglindore

Kryetarja i njoftoi të pranishmit se aktivitetet e Asamblesë Parlamentare të Procesit të Bashkëpunimit për Evropën Juglindore do të realizohen me platformën online. Diskutimi i kryetares është dhënë i plotë në transkript.

Kryesia, gjithashtu në lidhje me pikën e lartshënuar, mori edhe këtë:

V E N D I M

Lejohet pagesa e participimit për qasjen në platformën ZOOM 5.0 for Government në shumën prej 400 euro.

5.6 Njoftimi i Sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit

Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit, Ismet Krasniqi, e njoftoi Kryesinë e Kuvendit me kërkesën e Ministrisë së Financave për rishikim të buxhetit për vitin 2020, si dhe për shpenzimet, kursimet dhe shkurtime të deritashme të buxhetit. Diskutimi i plotë i Sekretarit është i dhënë transkript.

5.7 Caktimi i seancës solemne

Kryesi vendosi që Kuvendi, për nder të Ditës së Çlirimit të Kosovës, të mbajë seancë solemne të premtën, më 12 qershor 2020, në orën 11:00, me këtë:

Rend dite

1. Shënimi i 12 Qershorit - Dita e Paqes.

Kryetarja e Kuvendit e mbylli mbledhjen e Kryesisë së Kuvendit në orën 13:15 minuta.

Vjosa Osmani - SADRIU

Kryetare e Kuvendit

Procesverbalin e hartoi:

Drejtoria për Çështje Plenare dhe Procedurale